



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 01, dt. 13.03.2019

*MBI MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PER PROGRAMIN BUXHETOR
AFATMESEM 2020-2022*

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 68/2017 “Per financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjit “Për buxhetin e vitit 2019”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2 date 06.02.2012 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, Udhëzimit te Ministrise te Financave dhe Ekonomise nr. 23 date 22.11.2016 “Per procedurat standarte të përgatitjes të Programit Buxhetor Afatmesëm” me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

VENDOSI

1. Të miratojë tavanet përgatitore për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 sipas tabelës bashkangjitur:
 - Planin e transfertës së pakushtëzuar
 - Planin e transfertës së kushtëzuar
 - Planin e të ardhurave të Këshillit të Qarkut
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e financës, zhvillimit ekonomik dhe shërbimeve dhe Grupi i Menaxhimit Strategjik
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ana VERUSHE

Kryetari i Këshillit të Qarkut





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RAPORT

PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE PËR
PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2020-2022

Grupi i Menaxhimit Strategjik i kryesuar nga Kryetari i Keshillit të Qarkut ju paraqet raportin mbi vleresimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave mbeshetur në legjislacionin në fuqi si më poshte:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
- Ligjin nr.68 /2017“Per financat e vetqeverisjes vendore”
- Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.
- Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.23 datë 22.11.2016.“Për procedurat standarte të përgatitjes së Programit Buxhetor afatmesem”
- Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.2 dt 06.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit“
- Udhëzimi I Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 date 27.02.2019 “Per përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2020-2022”

Raporti i vleresimit dhe parashikimit afatmesem të të ardhurave është hapi i parë në procesin e hartimit të Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022 dhe paraqitet sipas strukturës së mëposhteme:

I. Organizimi I punës për hartimin e PBA –se 2020-2022

1. Ngritja e grupit të punës

Me Urdhër të Kryetarit të Keshillit të Qarkut u ngrit Grupi i Menaxhimit Strategjik për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për përgatitjen e programit buxhetor afatmesem 2020-2022, mbeshetur në programet dhe aktivitetet të miratuara në Keshillin e Qarkut. Grupi i Menaxhimit Strategjik do të mbeshetet në kalendarin për hartimin e programit buxhetor afatmesem miratuar me Vendim të Keshillit të Qarkut nr. 15 date 11.12.2018.

2. Ndarja e kuotave sipas programeve

Ne drejtimin e Kryetarit rre GMS, grupi i punes kapunuar per planifikimin e Programit Buxhetor Afatmesem 2020-2022 mbeshitetur ne:

- Mundesite reale te realizimit te burimeve te te ardhurave, si kusht per financimin e shpenzimeve.
- Analizen e realizimit te buxhetit ne dy vitet paraardhese si dhe ne realizimin e pritshem te tij per vitin 2019.
- Ritjen e lejuar te transfertes se pakushtezuar te parashikuar ne Udhezimin e Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 7 date 27.02.2019 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2020-2022".
- Programi i aktiviteteve per vitin 2019 per institucionin e Keshillit te Qarkutte lidhura me objektivat e zhvillimit te qeverisjes vendore.
- Parashikimi i pritshem i realizimit te kontratave per implementimin e Projekteve te fituara me fonde te Bashkimit European ne kuader te Programeve te Bashkepunimit nderkufitar IPA CBC Greqi – Shqiperi 2014-2020.
- Normativat e lejuara te shpenzimeve te miratuara me akte ligjore e nenligjore.

Tabela e realizimit te te ardhurave sipas programeve per periudhen 2017-2019

Programi	Emertimi i te Ardhurave	Fakti 2017	Fakti 2018	Plani 2019
01110	Transferta e pakushtezuar	47421446	49489605	52550609
01110	Te ardhurat e veta	1730991	1434400	7800000
01110	Te ardhurat e trasheguara	34343000	57527469	73288777
01160	Transferta e kushtezuar	6920000	6770000	6715000
	Te ardhura gjithsej	90415437	115221474	140354386

Ne zbatim te Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr. 7 date 27.02.2019 "Per pergatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem Vendor 2020-2022", eshte percaktuar vlera e transfertes se pakushtezuar per periudhen 2020-2022 perkatesisht per sejcilin vit me nje ritje prej 10 % per 2020, 9% per 2021 dhe 8 % per 2022. Kjo ritje eshte relativisht e ndjeshme. Lidhur me planifikim e transfertes se kushtezuar (fondet e deleguara per DAMT ne qark) grupi i punes, duke patur parasysh edhe aktivitetin e kesaj drejtorie si dhe nivelin e ritjes se transfertes se pakushtezuar, propozon qe ritje e ketij treguesi te shkoje ne % te njejta si transferta e pakushtezuar. Lidhur me planifikimin e te ardhurave te vete institucionit, grupi i punes mori ne analize realizimin e tyre ne tre vitet paraardhese, si dhe legjislacionin ne fuqi me ndryshimet qe ka pasuar ne vitet e fundit dhe gjykoi qe niveli i te ardhurave te planifikohet ne nivelin e vitit 2019. Te ardhurat e veta perbehen nga kontributi financiar i bashkive dhe te ardhurat nga tarifat e sherbimeve qe ofron keshilli i qarkut. Aktualisht Keshilli i Qarkut ofron tarifa vetem nga DAMT dhe shume rralle nga arkivi i Urbanistikes.

Pjese e diskutimit ishin edhe projekt idete per aktivitetet qe do te planifikohen ne vitet ne vazhdim me synim arritjen e objektiveve te Keshillit te Qarkut. Planifikimi i tavanave te te ardhurave per tre vitet e ardheshme do te sherbeje si tregues kryesor per planifikimin e shpenzimeve sipas programeve dhe aktiviteteve ne permbushje te objektiveve te Keshillit te Qarkut, kjo e lidhur edhe me Programin Buxhetor Afatmesem 2019-2021 perfundimtar te miratuar ne Keshillin e Qarkut ne Dhjetor 2018. Disa nga objektivat kryesore te Keshillit te Qarkut te cilat jane mare ne konsiderate ne hartimin e Programit Buxhetor Afatmesem jane si me poshte:

- Hartimi dhe zbatimi i politikave rajonale dhe harmonizimi i tyre me politikat e qeverisjes qendrore.
- Hartimi i Planit Sektorial për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik për territorin e Qarkut Korçe.
- Pjesëmarrja në Programet nderkufitare e me gjere dhe krijimi i partneriteteve për një zhvillim të qëndrueshëm rajonal.
- Nxitjen e bashkëpunimit midis njesive te qeverisjes vendore te Rajonit, si dhe bashkepunimin nderrajonal.
- Përmirësimi i shërbimeve të ofruara komunitetit dhe sigurimi i një qeverisje më të mire.
- Përmirësimi i rolit të Qarkut dhe njesive përbërëse të tij, në procesin e Integritimit European.

Me poshte paraqitim tabelen e parashikimit te te ardhurave per tre vitet e ardhshme:

Tabela e planifikimit te tavaneve per gatitore te PBA 2020-2022

Programi	Emertimi i te Ardhurave	Parashikimi i vitit 2020	Parashikimi i vitit 2021	Parashikimi i vitit 2022
01110	Transferta e pakushtezuar	57805670	63060731	68315792
01110	Te Ardhurat e veta	7800000	7800000	7800000
01160	Transferta e kushtezuar (DAMT)	7386500	8051285	8695387
	Te ardhura gjithsej	72992170	78912016	84811179

Grupi i Menaxhimit Strategjik

Kryetar i Keshillit te Qarkut	Ana Verushi
Drejtoresh e Finances	Liljana Pleqi
Shef i Kabinetit, Keshilltar Juridik	Gjergji Kristo
Keshilltare per Projektet Komunitare	Mariela Alickolli
Specialist per Urbanistiken e Mbrojtje e territorit	Anesti Teneqexhi
Specialist per Sherbimet e Burimet Njerezore	Edi Qirinxhi

KESHILLI I QARKUT KORCE

TAVANET PERGATITORE TE PBA 2020-2022

TRANSFERTA E PAKUSHTEZUAR
KESHILLI I QARKUT

2020	2021	2022
57,805,670.00	63,060,731.00	68,315,792.00

TRANSFERTA E KUSHTEZUAR
Funksion I Deleguar - DAMT

2020	2021	2022
7,800,000.00	7,800,000.00	7,800,000.00

TE ARDHURA TE PLANIFIKUARA
KESHILLI I QARKUT

2020	2021	2022
7,386,500.00	8,051,285.00	8,695,387.00

TOTALI
KESHILLI I QARKUT

2020	2021	2022
72,992,170.00	78,912,016.00	84,811,179.00

ANA VERUSHI

KRYETAR I KESHILLIT TE QARKUT

